



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Mekanizmi Kombëtarë për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401998/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda : *Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Korçë dhe Komisaritet në varësi të saj.*

Drejtuar : **Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit**
Z. Artan DIDI

TIRANË

Drejtorit të Policisë së Qarkut Korçë
Z. Edmond TARHAJ

KORÇË

Për dijeni : **Ministrit të Punëve të Brendshme**
Z. Saimir TAHIRI

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në mbështetje të nenit 19/1 të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi në datat 28 dhe 30 Tetor 2014, Komisaritet e Policisë, në varësi të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Korçë.

Inspektimi u krye nga ekspert të Njesisë për Parandalimin e Torturës Znj. Jorida Rustemi (Drejtuese e Njesisë, psikologe), Alfred Koçobashi ekspert ligjorë dhe Znj. Alma Alibali mjeke.

Objektivat specifike të monitorimit

Monitorimi kishte si objekt inspektimin, kryerjen e vizitave, vëzhgimin, mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave, veprimeve dhe praktikave të ndjekura nga policia në përmbushje të standardeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", Manualin "Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore", dhe marrjen e masave për plotësimin e rekomandimeve të tij, si dhe

të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në përmbushje të Rekomandimit 2013 lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë sipas standardeve ligjore, heqjen nga përdorimi të dhomave që nuk plotësojnë kriteret e domosdoshme, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit gjatë shoqërimit apo ndalim/arrestimit të shtetasve.

Grupi i punës inspektoi objektet si më poshtë:

- Komisariatit e Policisë Korçë
- Komisariatit e Policisë Pogradec
- Komisariatit e Policisë Devoll
- Komisariatit e Policisë Ersekë

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit, grupi i punës zhvilloi fillimisht takimin me drejtuesit e këtyre institucioneve dhe ju komunikoi atyre qëllimin e vizitës. Nga ana e drejtuesve të këtyre organeve u shpreh gatishmëri për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit inspektues. Në vijim të inspektimit, ekipi pati konsultime të frytshme me Shefat e Rendit dhe të Sigurisë Publike në Komisaritet e Policisë Korçë, Pogradec, Ersekë dhe Devoll si dhe me zyrtarë të tjerë të këtyre njësive policore.

Grupi i punës mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës si dhe kontaktoi privatisht me personat e privuar nga liria. Inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore si dhe u njoh me të gjithë dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

Në bisedë me personelin e policisë, u njohëm me zbatimin e detyrave të lëna në kuadër të tërheqjes së vëmendjes nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë lidhur me shoqërimin dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, në ambientet e Policisë së Shtetit drejtuar Drejtorive të Policisë në Qarqe me anë të dok. Nr. 4577 prot. datë 18.09.2014.

Por gjatë inspektimit grupi i punës ka konstatuar se, megjithëse në këtë Drejtori Policie ishin realizuar disa masa, përsëri vazhdonin të ishin prezent disa problematika dhe konkretisht:

Kushtet e ambienteve të shoqërimit:

Në Komisariatit e Policisë Korçë mjediset e shoqërimit janë ndërtuar të reja dhe sipas gjithë kërkesave të Ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 "*Për Policinë e Shtetit*", pasi janë të ndara në mënyrë të veçantë për femrat, meshkujt dhe të miturit. Dhomat ishin me ndriçim nga rrjeti, me sistem ngrohje, të lyera, të pastra, me dyer normale dhe me tualet. Ato ishin të pajisura me të gjitha orënditë e nevojshme si tavolina, karrige apo stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Sipërfaqja dhe hapësira e dhomave ishte e bollshme për qëndrimin e personave të shoqëruar si dhe kishin dritare me përmasa normale, për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral. Brenda ambienteve të shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar.

Në Komisaritet e Policisë Pogradec, Ersekë dhe Devoll ambientet e vjetra të shoqërimit janë nxjerrë jashtë funksionit me Urdhër Nr. 239, datë 28.05.2012 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si ambiente jashtë standardeve të përcaktuara në aktet normative, në zbatim të rekomandimit të bërë nga Avokati i Popullit në vitin 2012.

Në të tre këto Komisariate Policie, të shoqëruarit mbaheshin në zyrat e punonjësve të policisë, në koridore ose në ambientet e përshtatura si ambiente intervistimi. Bazuar në Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, të shoqëruarit duhet të qëndronin në këto ambiente deri në verifikimin e identitetit të tyre, por jo për një kohë të gjatë. Gjatë inspektimit në këto ambiente nuk u gjetën persona të shoqëruar.

Ambientet e përshtatura, për intervistim paraqiten si më poshtë:

Në Komisarlatin e Policisë Pogradec është përshtatur një ambient intervistimi, i cili ndodhet në një ndërtesë një katëshe e shkëputur nga godina e Komisarlatit, por brenda territorit të tij. Dhoma është me dimensione 5x4m, me dritare normale nga e cila sigurohej ndriçim i plotë natyral, me ndriçim nga rrjeti, e lyer, e pastër, e mobiluar me tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të personave të intervistuar (shoqëruar). Brenda këtij ambienti ishin vendosur tabela me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar. Në Komisarlatin e Policisë Ersekë ka dy dhoma intervistimi të cilat ndodhen në katin e dytë të godinës së Komisarlatit. Dhomat janë me dimensione 5x4m dhe 4x3.5m, me derë druri, me dritare normale, të lyera, të pastra, me ndriçim nga rrjeti, me tavolinë dhe karrige për të qëndruar ulur personat e intervistuar, por në njërin prej dhomave të intervistimit nuk ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar.

Në Komisarlatin e Policisë Devoll është përshtatur një dhomë intervistimi, e cila ndodhet në katin e parë të godinës së këtij komisarlati. Dhoma është me dimensione 4x3.5m, me dy dritare normale nga të cilat sigurohej ndriçim i plotë natyral, me ndriçim nga rrjeti, e lyer, e pastër, e mobiluar me tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të personave të intervistuar (shoqëruar). Brenda këtij ambienti ishin vendosur tabela me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar.

Kushtet e ambienteve të sigurisë (paraburgimit):

Në strukturën e Komisarlatit të Policisë Ersekë dhe Devoll nuk ka ambient të sigurisë dhe personat e ndaluar/arrestuar dërgohen në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Korçë.

Në Komisarlatin e Policisë Korçë ka pesë dhoma sigurie nga të cilat një për të mitur, një për femra dhe tre për madhorë. Dhomat e sigurisë (paraburgimit), janë ndërtuar të reja dhe sipas parametrave të përcaktuar në Ligjin Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, pasi ishin të ndara më vete për femrat, meshkujt dhe të miturit. Dhomat plotësonin normat dhe parametrat teknike jetësore, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte 10 metër katror, ishte e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m². Ishin vendosur pajisjet dhe orëditë e nevojshme për jetesë si krevat, tavolinë, stola etj. Dyshekët, batanijet dhe jastëkët ishin të rinj dhe të pastër, por çarçaf nuk kishte. Për çdo ambient kishte tualet më vete, me ujë të rrjedhshëm. Brenda ambientit kishte dhe një dush me ujë të ngrohtë. Në korridor kishte një vend të caktuar ku ishte vendosur një citofon dhe një aparat telefonik i cili përdorej nga punonjësi i shërbimit në rastet e tentativave apo

ngjarjeve të rënda me të arrestuarit/ndaluarit me qëllim për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje. Të ndaluarit e arrestuarit nxirren nga dhoma e qëndrimit në paradhomë për nevoja të pastrimit dhe të higjienës personale në mëngjes, drekë e darkë gjatë kohës kur konsumojnë vaktet e ushqimit. Për efekt të sigurimit e ruajtjes së higjienës e pastërtisë në këtë ambient kryhej disa herë në ditë pastrimi dhe një herë në ditë klorifikimi i pajisjeve të tualeteve. Kontrolli i masave dhe i gjendjes higjieno - sanitare në dhomat e sigurisë kryhet në mënyrë periodike nga mjeku i Drejtorisë Policisë si dhe drejtuesit e komisariatit të policisë. Ambienti kishte pajisje audiovizive (kamera) për survejimin e mbajtjen në kontroll të personit të arrestuar/ndaluar.

Gjatë inspektimit u konstatua se në këtë ambient sigurie nuk ka telefon me numër, me qëllim që të ndaluarit/arrestuarit të komunikojnë më familjarët e tyre. Të ndaluarit/arrestuarit, nuk e kanë mundësinë e zgjedhjes së mbrojtjes, pasi lista e avokatëve mbrojtës nuk është e ekspozuar megjithatë u konstatua se personave të ndaluar /arrestuar u ishte krijuar mundësia e kontaktit dhe takimit me avokatët. Në momentin e inspektimit në këto ambiente ndodheshin 13 persona të ndaluar/të arrestuar, nga të cilët 2 ishin te mitur.

Në Komisarlatin e Policisë Pogradec ka 5 dhoma sigurie të mbartura nga ish dhomat e parburgimit të cilat nuk plotësojnë standardet e përcaktuara në Ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007 "*Për Policinë e Shtetit*" dhe Manualit "*Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore*", pasi janë me shumë lagështi dhe me mundësi të pakët ajrimi. Gjendja në të cilën ato ndodhen dëmton rëndë shëndetin e personave të ndaluar/arrestuar. Për këtë arsye këto dhoma janë nxjerrur jashtë përdorimi nga ana e DPP dhe të ndaluarit/arrestuarit në Komisarlatin e Pogradecit transferohen në Komisarlatin e Korçës.

Në momentin e inspektimit në këto ambiente nuk ndodheshin persona të ndaluar/arrestuar por meqenëse këto ambiente nuk ishin të mbyllura dhe vulosura nga një komision sipas procedurave administrative dhe të sigurisë krijohej përshtypja se këto ambiente përdoren për funksione të ndryshme.

Kushtet e ambienteve të intervistimit dhe të hetimit:

Në Komisarlatin e Policisë Korçë ka një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve nga përfaqësuesit e akuzës dhe avokati Në dhomë nuk kishte orendi, sende apo pajisje të tjera që shkaktojnë presion apo dhunë psikologjike tek të ndaluarit/arrestuarit apo që mund të shërbejnë si mjet dhune.

Ndërsa ambient të veçantë hetimi, të monitoruar, për kryerjen e veprimeve procedurale nga Oficerët e Policisë Gjyqësore nuk ka në asnjë nga Komisarlatet e Policisë të DPQ Korçë.

Në zyrat e oficerëve të policisë të cilat përdoren edhe si zyrë hetimi nuk u gjetën sende apo prova materiale prania e të cilave ekspozon dhunë tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.

Monitorimi i ambienteve të shoqërimit të sigurisë dhe hetimit:

Duke përjashtuar Komisarlatin e Policisë Korçë, në komisarlatet e tjera nuk ka sistem monitorimi filmik për të mbajtur të survejuar ambientet e shoqërimit, të sigurisë dhe të hetimit. Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme,

si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve në ambientet e sigurisë:

Trajtimi me ushqim i të ndaluarve/arrestuarve

Në Komisariatet e Policisë Korçë të ndaluarit/arrestuarit trajtohen me ushqim sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Urdhërin e Përbashkët Nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Ministrit të Shëndetësisë, pasi në bisedë me të ndaluar/arrestuarit u konstatua se ata merrnin ushqim nga policia.

Gjatë monitorimit në vend lidhur me mënyrën e furnizimit me ushqim, normës së përdorur si dhe kushteve të mbajtjes së tij është konstatuar se mbahej procesverbali për furnizimin me ushqim (me racione) të personave të ndaluar/arrestuar dhe përpilohej nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, ndërsa kërkesa për furnizim bëhej me telefon.

Trajtimi mjekësor i të ndaluarve/arrestuarve

Në organikën e Drejtorisë së Policisë Qarkut Korçë ka një mjek të përgjithshëm i cili brenda ambienteve të sigurisë në Komisariatet e Policisë Korçë ka një ambient (dhomë) të përshtatshëm për të bërë vizita. Medikamentet e kutisë së ndihmës së shpejtë, si dhe ato të sëmurëve kronikë siguroheshin në mënyrë të vazhdueshme me fondet e Drejtorisë së Policisë. Në raste të rralla ata siguroheshin nga familjarët e të ndaluarve/arrestuarve sipas kërkesë së këtyre të fundit.

Në Komisariatet e Policisë Ersekë dhe Devoll, nuk ka as dhomë për mjekun dhe as mjek, pasi këto komisarate nuk kanë ambiente sigurie ku qëndrojnë persona të ndaluar/arrestuar.

Nga këqyrja e dokumentacionit që mbahet për këtë shërbim si dhe në bisedë me mjekun e drejtorisë rezultoi se të ndaluarve/arrestuarve ju bëhet kontrolli mjekësor sipas kërkesave të ligjit (brenda 24 orëve) shoqëruar me kartelën mjekësore për secilin, të plotësuar në dy kopje ku njëra prej tyre mbahej nga mjeku i këtij institucioni. Ndërkohë që vizitat e mjekut hidheshin në një regjistër të sekretuar, i cili nuk plotësohej nga mjeku i institucionit por nga personeli i dhomave të sigurisë.

Të ndaluarve/arrestuarve u ofrohej mundësia të lexonin shtypin e ditës, i cili sigurohej me shpenzimet e veta, si dhe u lejohej mbajtja e letrës dhe lapsit për të shkruar, pasta dhe furça e dhëmbëve, pasta e rrojës dhe brisqe rroje të plastifikuar.

Të ndaluarve/arrestuarve u sigurohet nga komisaritet e policisë sapun, detergjentë, letër higjienike, letra për fshirjen e duarve ose peshqir e mjete të tjera për ruajtjen e higjienës vetjake e të ambientit ku qëndrojnë.

Të ndaluarve/arrestuarve nuk u krijohet mundësia për të komunikuar me telefon, me familjarët e tyre.

Brenda dhomave të sigurisë kishte të vendosur postera për të drejtat e personave të ndaluar dhe arrestuar në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja.

Librat (regjistrat) për evidentimin e personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe mënyra e trajtimit të tyre gjatë veprimeve që kryen policia:

Në të katër Komisariatet e Policisë u konstatua se, librat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të shtetasve janë modeluar sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, pasi në ta janë hapur të gjitha rubrikat ku duhet të pasqyrohen të dhëna për personat e shoqëruar, ndaluar/arrestuar, por konstatohet se ka raste që shtetasit e shoqëruar, ndaluar/arrestuar nuk regjistrohen në libër ose rubrikat e tij nuk plotësohen sipas kërkesave të përcaktuara në ligj.

Më konkretisht, rubrika e njoftimit të familjarëve, përsëri nuk plotësohet saktë, pasi shkruhet “u njoftua familja” dhe nuk hidhen të plota të dhënat e personit që mori njoftimin. Njoftimi i familjarëve të të shoqëruarit për shoqërimitin e tij në polici dhe arsyet ligjore, përbën detyrim ligjor për punonjësit e policisë, i cili është parashikuar në nenin 107 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Punonjësit e policisë pretendonin se bëhej njoftimi i familjarëve, mirëpo fakti që nuk pasqyrohet në libër ky veprim, lë vend për dyshime.

Në ballafaqimin që grupi i monitorimit i bëri praktikave të punës së policisë me librat e shoqërimit të shtetasve, rezultoi se, në disa raste, janë shoqëruar në polici persona jashtë kriterëve ligjore të përcaktuara në nenet 11/6, 101/1/ “a” dhe “b” dhe 106 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Vazhdohet të trajtohen si të shoqëruar persona që kanë kryer apo dyshohen se kanë kryer vepra penale si, vrasje, vjedhje, kundërshtim të punonjësve të policisë, persona që janë në kërkim, persona për shkak të konflikteve midis tyre, për prishje rendi, për rrahje, për dhunë në familje, shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor etj, megjithëse këta persona kanë qenë të identifikuar.

Grupet e personave të shoqëruar në mënyrë të paligjshme të konstatuar gjatë inspektimit mund të kategorizohen si më poshtë :

Persona që kanë kryer apo dyshohen se kanë kryer vepra penale si, vrasje, kundërshtim të punonjësve të policisë, vjedhje, prishje të rendit dhe qetësisë publike, rrahje, dhunë në familje etj. Në këto raste policia duhet të veprojë sipas dispozitave ligjore, neni 253 i K.Pr.Penale.

Persona për të cilët lind nevoja për të marrë prej tyre informacion për parandalimin e një rreziku, për të identifikuar persona që mund të kenë dijeni për rrezikun apo incidentin dhe për të identifikuar shkelësit e mundshëm të ligjit. Në këto raste nga ana e punonjësve të policisë duhet aplikuar e drejta ligjore për “njoftim për paraqitje në polici”, e parashikuar në nenin 100 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe jo të bëhet shoqërimi i tyre në organin e policisë.

Persona në kërkim. Vlen të theksohet se për këtë kategori personash ndaj të cilëve është nxjerrë urdhër ekzekutimi i një vendimi penal, si dhe në rastet kur një person ka kryer më parë apo dyshohet si autor i mundshëm i një vepre penale (është fjala kur nuk jemi në kushtet e flagrancës), ai duhet të ndalohet sipas neneve 253 dhe 464 të K.Pr.Penale. Kjo dukuri konstatohet pothuajse në të gjitha Komisariatet e Policisë përveç Komisarariatit të Devollit efektivet e të cilit kishin proceduara dhe kuptim korrekt të institutit të shoqërimit dhe respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar.

Persona të shoqëruar për shkak të një konflikti, veprim i cili nuk është i parashikuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit”. Këto janë rastet që dominojnë

pothuajse në të gjitha Komisaritet e Policisë së kësaj drejtorie. Meqenëse qëllimi i shoqërimit nga policia në këtë rast është për parandalimin e ndonjë krimi të mundshëm ndërmjet të konfliktuarve, ne nuk i kemi konsideruar veprimet e policisë si jo korrekte, por kjo nuk do të thotë që këta persona të trajtohen me statusin e personave të shoqëruar.

Personat e kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale apo menjëherë pas kryerjes së saj, duhet të arrestohen menjëherë sipas nenit 251 të K.Pr.Penale dhe pa e mbajtur atë në gjendje shoqërimi 10 orë.

Ndërsa ndaj personave që tregojnë rrethana të dobishme për hetimin, nga ana e punonjësve të policisë duhet aplikuar e drejta ligjore e parashikuar në nenin 312 i K.Pr.Penale dhe nenin 100 të ligjit *“Për Policinë e Shtetit”* duke i thirrur ata me urdhër apo fletë thirrje dhe paralajmëruar për shoqërim të detyrueshëm në rast mosparaqitje pa patur pengesë të ligjshme.

Në shumë raste arsyeja e shoqërimit në Komisaritet e Policisë vazhdon të jetë *“për verifikim”*. Kjo lloj arsyeje e shoqërimit është e përgjithshme dhe ka nevojë që të specifikohet konkretisht se për çfarë verifikimi konkret bëhet fjalë. Nga verifikimet e bëra në librat e shoqërimit dhe pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se, arsyeja e shoqërimit shënohet *“për verifikim”* edhe kur në fakt personi shoqërohet për rastet e tjera përmendura më lartë.”

Bazuar në informacionet e marra nga vet punonjësit e policisë vërehet se të shoqëruarve, në të gjitha organet e policisë ju bëhet kontrolli personal dhe u hiqen e bllokohen sendet personale. Ky veprim vjen në kundërshtim me nenin 106, pika 3 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”* në të cilin është parashikuar se: *“Punonjësi i policisë bën kontrollin dhe këqyrjen fizike, me qëllim marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të sëmurë mendorë, të dehurve, të droguarve ose ndaj personave me sëmundje ngjitëse”*. Ndërsa lidhur me bllokimin e sendeve personale, në nenin 108 të ligjit *“Për Policinë e Shtetit”* është përcaktuar se: *“Sendet mund të bllokohen vetëm nëse është krejtësisht i pashmangshëm evitimi i kërcënimit të çastit ndaj rendit dhe sigurisë publike”*.

Gjithashtu gjatë këtij inspektimi përsëri është konstatuar se në shumicën e Komisariateve të Policisë nuk respektohen kriteret ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9749, dt. 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe Kodin e Procedurës Penale, lidhur me orën e ndalimit apo arrestimit të shtetasve. Duke vendosur në procesverbalet e arrestimit dhe të ndalimit orën e përpilimit të procesverbaleve të arrestimit apo ndalimit dhe jo orën faktike, kur ju është privuar liria në fakt, atyre nuk u llogaritet në kohën e paraburgimit dhe më pas edhe atë të vuajtjes së dënimit, koha e qëndrimit si të shoqëruar, gjatë së cilës policia bën verifikime apo veprimet e ndryshme procedurale, kohë e cila mund të shkojë deri në 10 orë. Në bazë të neneve 144, 250 të K.Pr.Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilës prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Mbajtjen në këtë gjendje punonjësit e policisë e justifikojnë me mendësinë se, *“në qoftë se do t'i arrestojnë personat që në momentin e parë, atëherë nuk mund të kryejnë asnjë veprim procedural për të provuar veprën e kryer”*. Ky qëndrim dhe justifikim nuk ka mbështetje ligjore, përkundrazi bëhet në

kundërshtim me dispozitat e K.Pr.Penale. Sipas neneve 30 dhe 294 të K.Pr.Penale, *policia gjyqësore*, atributet e të cilës i kanë edhe punonjësit e Policisë së Shtetit, “*edhe pas referimit të veprës penale te prokurori, ka të drejtë të kryejë me iniciativën e vet funksionet e tij ligjore si, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme të veprës penale, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal*”.

Këto fenomene vazhdojnë të ekzistojnë, ndonëse për këtë problem janë bërë rekomandime dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka nxjerrë Letër-Porosinë Nr. 4577, dt. 18.09.2014 “*Për shoqërimin dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar gjatë veprimtarisë së Policisë së Shtetit*”. Në përmbajtje të saj parashikohet që, personat e dyshuar si autorë të veprave penale dhe ata të dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, të mos trajtohen e mbahen si të shoqëruar, por ndaj tyre të aplikohet menjëherë masa e arrestit në flagrancë apo e ndalimit.

Në intervistën me personat e ndaluar dhe arrestuar grupi i punës një rëndësi të veçantë i kushtoi mënyrës së trajtimit fizikë të këtyre personave gjatë qëndrimit në këto ambiente. Gjatë intervistave nuk pati pretendime për ushtrim të dhunës fizike nga punonjës të Policisë së Shtetit në ambientet e dhomave të sigurisë.

Avokati i Popullit pavarësisht rikujton se trajtimi i shtetasve në këto ambiente, duhet të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat dhe standardet e përcaktuara në Kushtetutë, Aktet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, K.Pr.Penale, si dhe në zbatim të të gjitha akteve të tjera ligjore e nënligjore ndaj individëve që u është privuar liria. Në aktet e mësipërme parashikohet se përdorimi i torturës, dhunës, trajtimit degradues, diskriminues, jo human apo çnjerëzor, përfshirë edhe dhunën verbale, si kërcënime, fyerje e cila krijon përshtypjen dhe imazhin e frikës, pasigurisë për jetën e shëndetin e të ndaluarve dhe arrestuarve apo dhe të familjarëve të tyre, janë veprime të dënueshme dhe duhen të parandalohen nga çdo institucion i administratës publike pjesë përbërëse e të cilës është dhe Policia e Shtetit.

Sipas informacionit të dhënë nga punonjësit e policisë që punojnë në ambientet e sigurisë rezulton se në dhomat e sigurisë mbahen persona të paraburgosur ndaj të cilëve është caktuar masa e sigurimit “*arrest në burg*”, si dhe persona të ndaluar për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim të formës së prerë, të dhënë në mungesë. Ata nuk dërgohen në kohë në institucionet e paraburgimit dhe ato të burgimit në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për shkak të pengesave që krijon vazhdimisht kjo Drejtori. Koha e qëndrimit të tyre në ambientet e policisë pas caktimit të masave të sigurimit ose pas ndalimit shkon deri në 15 ditë.

Libri i ankesave të qytetarëve të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar është hapur në të gjithë Komisaritet e Policisë, por ai nuk është plotësuar është vënë në funksion.

Ndihma juridike dhe psikologjike:

Në organikën e Drejtorisë së Policisë Qarkut Korçë është parashikuar një specialist psikolog. Gjatë inspektimit u konstatua se Oficerët e Policisë Gjyqësore nuk siguronin praninë e avokatit dhe të psikologut në të gjitha rastet

që nevojitej. Kështu p.sh. në Komisarjatin e Policisë Korçë u konstatua se shtetasi i mitur Altet Jauldashi 17 vjeç ishte pyetur pa ju siguruar ndihma (asistenca) psikologjike, siç parashikohet në nenet 35 e 49 të K.Pr.Penale. Shkeljet e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar nga policia, vijnë për faktin se nga punonjësit e policisë të rolit bazë ka mungesë të njohurive në zbatim të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”*, të veprimtarisë së institucioneve të pavarura në mbrojtje të të drejtave të njeriut, ligjit për Avokatin e Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Protokollit Opsional të Konventës Kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT), si dhe të Konventave Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

Me qëllim zgjidhjen e problemeve të mësipërme, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit në Komisarjatet e Policisë, Pogradec, Devoll dhe Ersekë sipas kërkesave të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe në zbatim të Letër-Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 703, dt. 07.08.2008, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
2. Marrjen e masave të nevojshme për mbylljen dhe dyllosjen faktike sipas procedurave administrative dhe të sigurisë të ambienteve të dhomave të vjetra të ndalim/arrestimit në Komisarjatet Pogradec, Ersekë dhe Devoll.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për korrigjimin e mangësive të konstatuara në librin e personave të shoqëruar/ndaluar dhe arrestuar në Komisarjatet Ersekë dhe Korçë me qëllim standardizimin sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe Manualin *“Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”*.
4. Marrjen e masave që në librat përkatës të pasqyrohen të gjitha veprimet e policisë duke i kushtuar një rëndësi të veçantë kohës dhe arsyes së shoqërimit/ndalimit apo arrestimit, vendit ku është mbajtur, kohës kur personi ka mbërritur në mjediset e policisë, kur është informuar për të drejtat e tij, kur është pyetur si dhe kur ka pasur kontakte me një anëtar të familjes, një avokat, një mjek apo psikolog kur ai është i mitur.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar që çdo person i shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia, për çfarëdo arsye, të informohet

menjëherë në momentin e ndalimit për të drejtat që i njeh ligji procedural penal. Kjo gjë kërkon që në momentin e ndalimit personit ti njoftohen në mënyrë të përmbledhur të drejtat e tij, dhe më pas në vendin ku do të merret në pyetje ose do të kryhen veprimet e tjera procedurale ti vihen në dispozicion materiale të shkurtra informuese në një gjuhë të kuptueshme për të, ku listohen të drejtat e personit të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar.

6. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat drejtuese të organeve qendrore e vendore të Policisë së Shtetit për njohjen e të gjithë efektivit me ligjin *“Për Policinë e Shtetit”* dhe letër-porositë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë lidhur me zbatimin me rigorozitet të kriterëve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë, si dhe për trajtimin dinjitoz të tyre.

7. Marrjen e masave për sigurimin e ndihmës juridike që në momentin që personit i privohet liria dhe sigurimin e përfaqësuesit ligjor falas, për të gjithë kategorinë e personave që nuk kanë mundësi financiare për ta siguruar atë.

8. Marrjen e masave për sigurimin e ndihmës së detyrueshme juridike dhe psikologjike në rastet e arrestimit apo ndalimit të personave të mitur si dhe për njoftimin e familjarëve të tyre.

9. Marrjen e masave për respektimin me korrektesë të dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe mostrajtimin e tyre fillimisht si të shoqëruar.

10. Marrjen e masave për vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të hetimit në të gjithë Komisaritetet e Policisë të DPQ Korçë ku ai mungon. Monitorimi duhet të fillojë nga hyrja e ndërtesës së organit të policisë, me qëllim për të mos patur asnjë moment shkëputjeje deri në ambientin ku personi do qëndrojë.

11. Marrjen e masave për vendosjen e telefonit me numër në ambientet e sigurisë në Komisaritin e Policisë Korçë, me qëllim që të ndaluarit/arrestuarit të kenë mundësi të komunikojnë më familjarët e tyre sipas përcaktimeve të bëra në Manualin *“Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”*.

12. Marrjen e masave për transferimin e menjëhershëm nga ambientet e policisë, në institucionet e paraburgimit dhe burgimit, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të të gjithë të paraburgosurve ndaj të cilëve është vendosur masa e sigurimit *“arrest në burg”* dhe e të ndaluarve për efekt të ekzekutimit të vendimit penal të dënimit të tyre në mungesë me *“burgim”*.

13. Marrjen e masave për vënien menjëherë në funksion të librit për ankesat e shtetasve të shoqëruar, ndaluar/arrestuar duke i kushtuar rëndësi të veçantë rubrikave për pasqyrimin e shenjave të lëndimit, emri i zyrtarit, i cili ka kryer veprimet si dhe vendi ku është mbajtur.

14. Marrjen e masave për pajisjen dokumentacionit të mjekut me një regjistër vizitash të sekretuar dhe plotësimin e tij vetëm nga mjeku i institucionit.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor konform nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI